



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 149

Tiranë – E martë, 28 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 69/2021, datë 23.9.2021	Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit... 14239
Vendim i Kuvendit nr. 70/2021, datë 23.9.2021	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit..... 14241
Urdhër i Kuvendit nr. 7, datë 27.9.2021	Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë..... 14242
Dekret i Presidentit nr. 13244, datë 23.9.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14243
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 22.9.2021	Për disa shtesa në vendimin nr. 687, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”..... 14243
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 23.8.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”..... 14270
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 23.8.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike 14271
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 23.8.2021	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Guri i zi’, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC ‘Daznjanë’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC ‘Shëlli’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw”..... 14272
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 23.8.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018..... 14273

Vendim i Entit Rregullator të
Energjisë nr. 179, datë 23.8.2021

Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021.....	14274
Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Adriano Jaho.....	14275
Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Albana Lleshi.....	14275



**VENDIM
Nr. 69/2021**

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË
SË KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e kryetares së Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Përbërja e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit është si më poshtë:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut:

1. Fatmir Xhafaj	anëtar	PS
2. Ermonela Valikaj	anëtare	
Felaj		PS
3. Damian Gjijnuri	anëtar	PS
4. Jurgis Çyrbja	anëtar	PS
5. Saimir Hasalla	anëtar	PS
6. Toni Gogu	anëtar	PS
7. Aurora Mara	anëtare	PS
8. Xhemal Qefalia	anëtar	PS
9. Gerta Duraku	anëtare	PS
10. Denis Deliu	anëtar	PS
11. Eduard Ndreca	anëtar	PS
12. Gledis Çeliku	anëtar	jashtë grupeve parlamentare
13. Gazment Bardhi	anëtar	PD
14. Enkelejd Alibeaj	anëtar	PD
15. Dhurata Tyli	anëtare	PD
16. Saimir Korreshi	anëtar	PD
17. Greta Bardeli	anëtar	PD
18. Dashnor Sula	anëtar	PD
19. Elda Hoti	anëtare	Aleanca për Ndryshim
20. Bledion Nallbati	anëtar	PD
21. Fatmir Mediu	anëtar	Aleanca për Ndryshim
22. Erisa Xhixho	anëtare	jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Integrimin Evropian:

1. Taulant Balla	anëtar	PS
2. Blendi Klosi	anëtar	PS

3. Bujar Çela	anëtar	PS
4. Orinaldo Rakipi	anëtar	PS
5. Etjen Xhafaj	anëtar	PS
6. Mimi Kodheli	anëtare	PS
7. Lavdrim Krrashi	anëtar	PS
8. Erisa Xhixho	anëtare	jashtë grupeve parlamentare
9. Edi Paloka	anëtar	PD
10. Luçiano Boçi	anëtar	PD
11. Flutura Açka	anëtare	PD
12. Kreshnik Çollaku	anëtar	PD
13. Belind Këllici	anëtar	PD
14. Tomor Alizoti	anëtar	PD

Komisioni për Politikën e Jashtme:

1. Hatixhe Konomi	anëtare	PS
2. Lavdrim Krrashi	anëtar	PS
3. Alqi Bllako	anëtar	PS
4. Benet Beci	anëtar	PS
5. Blendi Klosi	anëtar	PS
6. Petro Koçi	anëtar	PS
7. Besion Ajazi	anëtar	PS
8. Klodiana Spahiu	anëtare	PS
9. Grida Duma	anëtare	PD
10. Kreshnik Çollaku	anëtar	PD
11. Shpëtim Idrizi	anëtar	Demokraci dhe Integrim
12. Tritan Shehu	anëtar	PD
13. Belind Këllici	anëtar	PD
14. Vangjel Dule	anëtar	Aleanca për Ndryshim
15. Greta Bardeli	anëtare	PD

Komisioni për Ekonominë dhe Financat:

1. Erion Braçe	anëtar	PS
2. Anila Denaj	anëtare	PS
3. Antoneta Dhima	anëtare	PS
4. Pranvera Resulaj	anëtare	PS
5. Vullnet Sinaj	anëtar	PS
6. Benet Beci	anëtar	PS
7. Shpresa Marnoj	anëtare	PS
8. Alban Xhelili	anëtar	PS
9. Enslemvera Zake	anëtare	PS
10. Edmond Spaho	anëtar	PD
11. Jorida Tabaku	anëtare	PD
12. Alfred Rushaj	anëtar	PD
13. Bujar Leskaj	anëtar	PD
14. Arbi Agalliu	anëtar	PD
15. Agron Shehaj	anëtar	PD
16. Emilja Koliqi	anëtare	Aleanca për Ndryshim
17. Dashamir Shehi	anëtar	Aleanca për Ndryshim

**Komisioni për Sigurinë Kombëtare:**

1. Paulin Sterkaj	anëtar	PS	9. Lindita Buxheli	anëtare	PS
2. Antoneta Dhima	anëtare	PS	10. Gertjan Deda	anëtar	jashtë grupeve parlamentare
3. Bardhyl Kollçaku	anëtar	PS	11. Petrit Vasili	anëtar	jashtë grupeve parlamentare
4. Luan Duzha	anëtar	PS	12. Grida Duma	anëtare	PD
5. Vullnet Sinaj	anëtar	PS	13. Orjola Pampuri	anëtare	PD
6. Denis Deliu	anëtar	PS	14. Tritan Shehu	anëtar	PD
7. Pranvera Resulaj	anëtare	PS	15. Mesila Doda	anëtare	Demokraci dhe Integrim
8. Toni Gogu	anëtar	PS	16. Zheni Gjergji	anëtare	PD
9. Ilirian Pendavinji	anëtar	PS	17. Ilda Dhori	anëtare	Demokraci dhe Integrim
10. Agron Çela	anëtar	jashtë grupeve parlamentare	18. Seladin Jakupllari	anëtar	Demokraci dhe Integrim
11. Enkelejd Alibeaj	anëtar	PD			
12. Ervin Salianji	anëtar	PD			
13. Lindita Metaliaj	anëtare	PD			
14. Isuf Çelaj	anëtar	PD			
15. Ferdinand Xhaferraj	anëtar	PD			
16. Luan Baçi	anëtar	PD			
17. Kasëm Mahmutaj	anëtar	Demokraci dhe Integrim			

**Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin:**

1. Fadil Nasufi	anëtar	PS
2. Tatiana Piro	anëtare	PS
3. Luljeta Bozo	anëtare	PS
4. Ismet Beqiraj	anëtar	PS
5. Anduel Tahiraj	anëtar	PS
6. Ilir Ndraxhi	anëtar	PS
7. Rrahman Rraja	anëtar	PS
8. Baftjar Zeqaj	anëtar	PS
9. Alqi Bllako	anëtar	PS
10. Flamur Hoxha	anëtar	PD
11. Fatjon Veizaj	anëtar	PD
12. Lefter Gështenja	anëtar	PD
13. Zef Hila	anëtar	PD
14. Ramadan Likaj	anëtar	PD
15. Xhelal Mziu	anëtar	PD
16. Agron Duka	anëtar	Aleanca për Ndryshim
17. Nusret Avdulla	anëtar	Demokraci dhe Integrim

**Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe
Shëndetësinë:**

1. Desantila Tahiraj	anëtare	PS
2. Florenc Spaho	anëtar	PS
3. Niko Kuri	anëtar	PS
4. Mirela Pitushi	anëtare	PS
5. Shpresa Marnoj	anëtare	PS
6. Ilir Metaj	anëtar	PS
7. Tatiana Piro	anëtare	PS
8. Anila Denaj	anëtare	PS

**Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e
Informimit Publik:**

1. Eduard Ndreca	anëtar	PS
2. Teuta Ramaj	anëtare	PS
3. Lindita Buxheli	anëtare	PS
4. Ilir Topi	anëtar	PS
5. Blerina Gjylameti	anëtare	PS
6. Florenc Spaho	anëtar	PS
7. Desantila Tahiraj	anëtare	PS
8. Enslemvera Zake	anëtare	PS
9. Meri Markiçi	anëtare	jashtë grupeve parlamentare
10. Flutura Açka	anëtare	PD
11. Luçiano Boçi	anëtar	PD
12. Ina Zhupa	anëtare	PD
13. Andia Ulliri	anëtare	Demokraci dhe Integrim
14. Eralda Bano Tase	anëtare	PD
15. Merita Bakiu	anëtare	Aleanca për Ndryshim
16. Kastriot Piroli	anëtar	PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 23.9.2021.



**VENDIM
Nr. 70/2021**

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE
ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 3, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut janë si më poshtë:

1. Alqi Bllako	Anëtar	PS
2. Etilda Gjonaj	Anëtare	PS
3. Arben Pëllumbi	Anëtar	PS
4. Bardhyl Kollçaku	Anëtar	PS
5. Lavdrim Krrashi	Anëtar	PS
6. Ervin Saliq	Anëtar	PD
7. Lindita Metaliaj	Anëtare	PD

II. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Integrimin Europian janë si më poshtë:

1. Florenc Spaho	Anëtar	PS
2. Bardhyl Kollçaku	Anëtar	PS
3. Klodiana Spahiu	Anëtare	PS
4. Aurora Mara	Anëtare	PS
5. Pranvera Resulaj	Anëtare	PS
6. Albana Vokshi	Anëtare	PD
7. Oerd Bylykbashi	Anëtar	PD

III. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Politikën e Jashtme janë si më poshtë:

1. Blerina Gjylameti	Anëtare	PS
2. Bardhyl Kollçaku	Anëtar	PS
3. Taulant Balla	Anëtar	PS
4. Ilirian Pendavinji	Anëtar	PS
5. Agron Gjekmarkaj	Anëtar	PD
6. Helidon Bushati	Anëtar	PD

IV. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Ekonominë dhe Financat janë si më poshtë:

1. Ilir Topi	Anëtar	PS
2. Ilir Metaj	Anëtar	PS
3. Etjen Xhafaj	Anëtar	PS
4. Mimi Kodheli	Anëtare	PS
5. Flamur Hoxha	Anëtar	PD
6. Fatjon Veizaj	Anëtar	PD

V. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Sigurinë Kombëtare janë si më poshtë:

1. Ermonela Valikaj (Felaj)	Anëtare	PS
2. Klevis Xhoxhi	Anëtar	PS
3. Bujar Çela	Anëtar	PS
4. Aurora Mara	Anëtare	PS
5. Alban Xhelili	Anëtar	PS
6. Dhurata Tyli Çupi	Anëtare	PD
7. Dashnor Sula	Anëtar	PD

VI. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin janë si më poshtë:

1. Ilirian Pendavinji	Anëtar	PS
2. Benet Beci	Anëtar	PS
3. Pranvera Resulaj	Anëtare	PS
4. Luan Duzha	Anëtar	PS
5. Orinaldo Rakipi	Anëtar	PS
6. Ilda Dhori	Anëtare	Demokraci dhe Integrim
7. Edmond Spaho	Anëtar	PD

VII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë janë si më poshtë:

1. Teuta Ramaj	Anëtare	PS
2. Ismet Beqiraj	Anëtar	PS
3. Antoneta Dhima	Anëtare	PS
4. Luan Baçi	Anëtar	PD
5. Lindita Metaliaj	Anëtare	PD

VIII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik janë si më poshtë:

1. Fadil Nasufi	Anëtar	PS
2. Ismet Beqiraj	Anëtar	PS
3. Luljeta Bozo	Anëtare	PS
4. Lavdrim Krrashi	Anëtar	PS
5. Ilir Metaj	Anëtar	PS
6. Sorina Koti	Anëtare	PD
7. Arbi Agalliu	Anëtar	PD



IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 23.9.2021.

URDHËR
Nr. 7, datë 27.9.2021

**PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT
LIGJOR TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, të neneve 28, 29, dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti, të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore dhe Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

4. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1/personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.

7. Përfaqësimi ligjor i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjykimit.

8. Urdhri nr. 1, datë 16.10.2017, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. ____ prot. (vendndodhja), më _____. 2021

LIDHJA I

AUTORIZIM

**PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN/ ADMINISTRATIVE/CIVILE/PENALE
DHE NË GJYKATËN KUSHTETUESE ME PALË**

Paditës/Kërkues _____

I paditur/subjekt i interesuar _____

Objekti _____

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrin të Kryetares së Kuvendit nr. ____, datë _____. 2021, “Për delegimin dhe rregullat e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”,

V E N D O S A

Autorizimin e z/znj _____, me detyrë _____, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile./gjykimin në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në (gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse)/ Gjykatës Kushtetuese.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

**DEKRET**

Nr. 13244, datë 23.9.2021

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 8, 20 e 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Genc Sali Dobrosi
2. Valmir Hakif Fazliu
3. Haki Naser Hasi
4. Drita Gani Canolli
5. Sadik Bajram Hoxha
6. Mohamed Abdelaziz Gaber Badawy
7. Fatmire Rahim Rexhepi
8. Mürsel Cemal Duzlu
9. Fayza Redwan Albunni
10. Hisham Mhd. Nazir Sammounch
11. Viktoriia Mykola Dusha (Topilnytska)
12. Ridvan Irfan Yildirim
13. Giovanni Roberto Angelo Fiocchi
14. Ahmed Elsayed Mohamed Ibrahim Elodimi
15. Agron Rexhep Sopaj
16. Idriz Femi Selmani
17. Jeton Arif Ninaj
18. Uğur Recep Ak
19. Granit Musli Murseli
20. Burim Ragip Letaj
21. Donik Xhevat Sallova
22. Hasan Isuf Haliti
23. Raffaele Antonio Fiori
24. Abraham Raffaele Fiori
25. Beniamino Raffaele Fiori
26. Miriam Raffaele Fiori
27. Maria Maddalena Raffaele Fiori
28. Francesca David Fabbriani
29. Giosue' Raffaele Fiori
30. Stefano Raffaele Fiori
31. Giovanni Paolo Raffaele Fiori
32. Elia Raffaele Fiori
33. Susanna Raffaele Fiori
34. Mohamad M. Kamel Halo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 538, datë 22.9.2021

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
687, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR MBAJTJEN,
PËRDITËSIMIN DHE PUBLIKIMIN E
STATISTIKAVE TË MBETJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 60, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 687, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatojnë metodologjinë për grumbullimin, gjenerimin dhe përpunimin e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për plotësimin e formatit të raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij vendimi.”.

2. Pas shtojcës 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet shtojca 4, “Metodologjia për grumbullimin dhe prodhimin e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE
Arben Ahmetaj



SHTOJCA 4
METODOLOGJIA PËR
GRUMBULLIMIN, GJENERIMIN DHE
PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PËR
MENAXHIMIN E MBETJEVE

I. METODOLOGJIA – KLASIFIKIMI
SIPAS SHKALLËS SË BESUESHMËRISË

Metodologjia ka për qëllim t'u mundësojë bashkive mënyrën se si ato të mbledhin të dhënat e kërkuara nga ky vendim dhe si të prodhojnë të dhëna të sakta dhe të besueshme për mbetjet, në rastet kur ato mungojnë.

Të dhënat e nevojshme janë grupuar në tri grupe:

- i. të dhënat për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve;
- ii. të dhënat për trajtimin e mbetjeve;
- iii. të dhënat për grumbullimin e diferencuar dhe rrymat specifike.

Kështu për çdo tregues, që bën pjesë në secilin prej grupeve të mësipërme dhe që kërkohet të raportohet nga bashkitë në kuadër të VKM-së së statistikave të mbetjeve, metodologjia përdor si logjikë tri nivele të besueshmërisë së grumbullimit apo prodhimit të të dhënave (C, B dhe A).

Niveli i gjenerimit të të dhënave, sipas metodës C është më pak i besueshëm dhe është i bazuar mbi supozime të thjeshta, të cilat gjithsesi u japin mundësi bashkisë, që të plotësojë raportimin. Ndërkohë që niveli i gjenerimit të të dhënave sipas metodës A është më shumë i besueshëm dhe është i bazuar në matje në terren, të cilat gjithsesi kërkojnë burime njerëzore dhe financiare. Kështu, duke marrë në konsideratë edhe kontekstin lokal, secila NJQV-vë mund të zgjedhë metodën e saj të raportimit me objektivin që niveli i gjenerimit të të dhënave të zhvendoset në një periudhë tranzicioni nga metodat me pak të besueshme C drejt atyre më

të besueshme A. Periudha e tranzicionit do të thotë:

- Për NJVQV-të, të cilat janë në zona mbetjesh që kanë impiant rajonal (lëndfill apo incenerator) të trajtimit të mbetjeve, ku mbetjet peshohen (Shkodër–Lezhë, Korçë, Vlora Jug Gjirokastrë), periudha e tranzicionit humbet si koncept. Ata duhet të përdorin metodën më të besueshme që parashikon të dhëna të matshme për mbetjet. Përfundimisht bëjnë ato njësi të vetëqeverisjes vendore që janë pjesë e këtyre zonave të mbetjeve, por nuk i dërgojnë mbetjet në impiantet rajonale (lëndfill apo incenerator), pasi janë mbi 30 km larg impiantit. Për këto njësi të vetëqeverisjes vendore periudha e tranzicionit zgjat deri në 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj VKM-je.

- Për NJVQV-të, të cilat janë në zona mbetjesh për të cilat ekzistojnë kontrata koncesionare (Elbasan, Fier dhe Tiranë), duhet të përdorin metodën më të besueshme që parashikon të dhëna të matshme për mbetjet.

- Për NJVQV-të, të cilat janë në zonat e mbetjeve që janë në fazën e studimit të fizibilitetit apo në fazën e ndërtimit të impianteve rajonale (landfill apo incenerator), (Vlora Veri, Kukës, Berati) apo si rasti i zonës së mbetjeve të Dibrës, për të cilin nuk kemi akoma studim fizibiliteti, periudha e tranzicionit për përdorimin e metodave më pak të besueshme është e vlefshme deri në fillimin e operimit të impiantit rajonal (jo më shumë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj VKM-je).

Në këtë mënyrë metodologjia jo vetëm do të udhëzojë njësitë e vetëqeverisjes vendore me mënyrë se si mund t'i gjenerojnë të dhënat e tyre, por, gjithashtu, do të mundësojë që të gjitha NJQV-të të raportojnë të dhënat e mbetjeve, ashtu siç kërkohen, pavarësisht nga stadi dhe niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e tyre.

Metoda C (më pak e besueshme)	Metoda B (mesatarisht e besueshme)	Metoda A (shumë e besueshme)
----------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------





Akoma më tej kjo metodologji prezanton një seri me tregues cilësor dhe sasior dhe nëpërmjet tyre synon që pas krijimit dhe popullimit të databazës së mbetjeve në çdo bashki, këto të fundit të jenë në gjendje që të matin performancës e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territoret e tyre.

II. TË DHËNAT PËR PLANIFIKIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Në grupin e të dhënave për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve bëjnë pjesë:

1. Numri i popullsisë [banorë];
2. Sasia e mbetjeve të prodhuara për person [kg/person/ditë];
3. Sasia e mbetjeve shtëpiake të prodhuara në bashki [kg/ose ton/vit].

2.1 Numri i popullsisë

Bashkitë duhet të përdorin numrin e popullsisë për llogaritjet e sasisë të mbetjeve që gjenerojnë, sipas formulës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke shmangur mospërputhjet që vijnë të dhënat e popullsisë sipas Regjistrat të Gjendjes Civile dhe Popullsisë së INSTAT-it (2011):

$$\text{Popullsia} = \text{Popullsia (CENSUS)} + [\text{Popullsia (Regjistri)} - \text{Popullsia (CENSUS)}] * 0.30$$

2.2 Sasia e mbetjeve të prodhuara për person

Bashkitë kanë katër mundësi për llogaritjen e sasisë së mbetjeve të prodhuara për person:

- a) përmes peshës së kamionëve;
- b) duke përdorur koeficientët e parashikuar në dokumentet strategjike;
- c) duke përdorur peshën e mbetjeve të regjistruara në impiantet e trajtimit;
- d) duke përdorur vëzhgime në terren.

2.2.1 Llogaritja e normës së gjenerimit përmes peshës së kamionëve – norma e gjenerimit I

Në mungesë të një peshoreje dhe buxhetit të kufizuar për ta lejuar atë në impiantin e trajtimit/fushën e grumbullimit, bashkitë duhet të japin informacion për shkallën e gjenerimit të mbetjeve bazuar në llogaritjen sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$w = c \times v \times d \times t \times l \times 365$$

ku: c – kapaciteti mesatar i kamionit (m^3 / automjet);

v – raporti mesatar i vëllimit dhe ngarkesës së kamionit = ngarkesa v/kamion;

d – densiteti mesatar i mbetjeve bashkiake në një kamion (ton/m^3);

t – numri mesatar i rrugëve që bëhet çdo ditë nga kamioni (rrugët/ditë);

l – numri mesatar i kamionëve që grumbullojnë në territorin e bashkisë (nr. kamionë/ditë);

w – sasia e mbetjeve vjetore e gjeneruar (ton/vit).

2.2.2 Llogaritja e normës së gjenerimit duke përdorur koeficientët e PKSMM – norma e gjenerimit II

Llogaritja e shkallës së gjenerimit të mbetjeve, duke përdorur koeficientin e parashikuar në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (masterplan/VKKT nr. 1, datë 13.1.2020), siç tregohet në tabelat më poshtë. Secila bashki mund t'u referohet tabelave më poshtë dhe të përdorë koeficientin sipas tipologjisë të vendbanimeve të zonës së shërbimit, apo normës indikative të llogaritur nga parashikimi i numrit të popullsisë sipas formulës të MFE-së dhe sasia e mbetjeve e parashikuar në masterplan:

Tabela I. Norma e gjenerimit të mbetjeve sipas tipologjisë së vendbanimit	
Llojet e vendbanimeve	Gjenerimi i mbetjeve (kg/banorë/ditë)
Kryeqyteti i vendit (Tiranë)	1.2
Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut > 35,000 banorë)	1.1
Qendër rajonale e bashkuar (qendra e bashkimit të vendbanimeve, > 20,000 banorë)	1.0
Qendër lokale (qendra e rrethit, jo e formuar nga bashkimet, < 20,000 banorë)	0.7
Zonë periferike metropolitane (brenda zonës Tiranë–Durrës)	



Njësi e vetëqeverisjes vendore jurbane të orientuara drejt turizmit	
Periferi (jashtë zonës metropolitane Tiranë–Durrës)	0.55
Njësi e vetëqeverisjes vendore jurbane pranë minierave apo burimeve të energjisë	
Njësi e vetëqeverisjes vendore të përziera industriale dhe shërbimesh	
Zona të përziera bujqësore fushore	0.4
Zona të përziera bujqësore malore	
Zona bujqësore fushore	
Zona bujqësore malore	

Tabela II ¹ Variacioni i normës së gjenerimit sipas masterplanit të mbetjeve	2020			...	...	2032		
	Popullsia	Sasia e mbetjeve	Norma e gjenerimit			Popullsia	Sasia e mbetjeve	Norma e gjenerimit
	nr.	ton/vit	kg/banorë/ditë			nr.	ton/vit	kg/banorë/ditë
Qarku Berat	155,650	38,538	0.68			135,283	33,602	0.68
Berat	66,516	20,603	0.85			58,510	18,123	0.849
Kuçovë	35,707	8,942	0.69			31,356	7,852	0.69
Polican	11,930	1,999	0.46			9,957	1,669	0.46
Skrapar	12,782	2,385	0.51			10,202	1,904	0.51
Ura Vajgurore	28,715	4,609	0.44			25,258	4,054	0.44
Qarku Dibër	135,113	25,826	0.52			114,525	21,890	0.52
Bulqizë	30,850	5,892	0.52			26,579	5,076	0.52
Dibër	60,384	12,263	0.56			51,087	10,375	0.56
Klos	16,116	2,353	0.40			13,618	1,988	0.40
Mat	27,763	5,318	0.52			23,241	4,451	0.52
Qarku Durrës	341,154	107,830	0.87			385,481	122,088	0.87
Durrës	234,226	81,228	0.95			267,202	92,664	0.95
Krujë	71,355	17,995	0.69			78,791	19,870	0.69
Shijak	35,573	8,607	0.66			39,488	9,554	0.66
Qarku Elbasan	325,241	75,247	0.63			303,252	70,310	0.64
Belsh	22,587	3,298	0.40			21,283	3,107	0.40
Cërrik	32,167	5,126	0.44			30,471	4,856	0.44
Elbasan	155,422	46,775	0.82			146,214	44,004	0.82
Gramsh	26,442	4,869	0.50			24,067	4,432	0.50
Librazhd	33,878	5,753	0.47			30,913	5,250	0.47
Peqin	28,556	4,929	0.47			26,083	4,502	0.47
Përrenjas	26,189	4,497	0.47			24,221	4,159	0.47
Qarku Fier	356,954	83,899	0.64			340,909	80,046	0.64
Divjakë	39,206	5,724	0.40			37,554	5,483	0.40
Fier	140,329	38,516	0.75			135,840	37,125	0.75
Lushnjë	94,486	21,489	0.62			89,664	20,392	0.62
Mallakastër	30,674	5,429	0.48			28,321	5,012	0.48
Patos	28,021	8,556	0.84			26,242	8,013	0.84
Roskovec	24,238	4,185	0.47			23,288	4,021	0.47
Qarku Gjirokastrë	87,938	20,798	0.65			77,102	18,186	0.65
Dropull	8,899	1,726	0.53			8,188	1,589	0.53
Gjirokastrë	32,708	10,135	0.85			28,400	8,800	0.85
Këlcyrë	7,888	1,526	0.53			10,078	1,950	0.53
Libohovë	4,279	752	0.48			3,645	641	0.48
Memaliaj	12,415	2,232	0.49			10,177	1,830	0.49
Përmet	11,680	2,422	0.57			8,231	1,707	0.57
Tepelenë	10,069	2,005	0.55			8,383	1,669	0.55

¹ Referuar të dhënave të Planit Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, miratuar me vendim KKT-je nr. 1, datë 13.1.2020.



Qarku Korçë	249,493	61,641	0.68			227,849	56,558	0.68
Devoll	30,048	5,827	0.53			27,251	5,284	0.53
Kolonjë	12,861	2,451	0.52			11,212	2,137	0.52
Korçë	89,061	29,256	0.90			82,888	27,229	0.90
Maliq	46,110	6,991	0.42			41,032	6,221	0.42
Pogradec	67,690	16,572	0.67			62,017	15,183	0.67
Pustec	3,723	544	0.40			3,449	504	0.40
Qarku Kukës	85,209	17,741	0.57			74,271	15,448	0.57
Has	16,874	3,124	0.51			15,010	2,779	0.51
Kukës	47,242	10,846	0.63			40,855	9,378	0.63
Tropojë	21,093	3,771	0.49			18,406	3,291	0.49
Qarku Lezhë	154,034	35,516	0.63			146,072	33,703	0.63
Kurbín	52,717	13,439	0.70			50,049	12,758	0.70
Lezhë	75,909	16,979	0.61			72,880	16,302	0.61
Mirditë	25,408	5,098	0.55			23,143	4,643	0.55
Qarku Shkodër	242,514	61,593	0.70			227,859	57,910	0.70
Fushë-Arrëz	8,290	1,459	0.48			7,591	1,336	0.48
Malësi e Madhe	36,339	6,361	0.48			33,641	5,889	0.48
Pukë	11,945	2,338	0.54			10,401	2,036	0.54
Shkodër	150,611	45,761	0.83			142,056	43,161	0.83
Vau Dejës	35,329	5,674	0.44			34,170	5,488	0.44
Qarku Tiranë	975,534	345,094	0.97			1,185,417	419,777	0.97
Kamzë	129,385	33,058	0.70			157,573	40,260	0.70
Kavajë	59,537	17,215	0.79			70,944	20,513	0.79
Tiranë	721,656	281,109	1.07			879,352	342,537	1.07
Rrogozhinë	31,323	5,119	0.45			36,341	5,939	0.45
Vorë	33,633	8,593	0.70			41,207	10,528	0.70
Qarku Vlorë	249,002	74,019	0.81			258,418	77,642	0.82
Delvinë	11,401	2,610	0.63			12,016	2,751	0.63
Himarë	14,178	3,210	0.62			14,608	3,307	0.62
Finiq	17,610	3,301	0.51			14,614	2,739	0.51
Konispol	10,336	1,509	0.40			10,397	1,518	0.40
Sarandë	33,091	11,542	0.96			39,777	13,874	0.96
Selenicë	23,009	3,531	0.42			22,987	3,528	0.42
Vlorë	139,377	48,316	0.95			144,019	49,925	0.95

2.2.3 Llogaritja e normës së gjenerimit, duke përdorur të dhënat e impianteve të trajtimit – norma e gjenerimit III

Sasia e mbetjeve të grumbulluara dhe të peshuara në të gjitha impiantet e trajtimit, e pjesëtuar me numrin e popullsisë, mund të përcaktojnë normën e gjenerimit të mbetjeve për atë pjesë të qytetit, ku ofrohet shërbimi.

Në këtë rast për të realizuar këtë llogaritje është e rëndësishme që sasia e mbetjeve të peshuara të jetë e grumbulluar vetëm në zonën e qytetit/NJA në fjalë, të jenë vetëm mbetje shtëpiake (pra të mos ketë lloje të tjera mbetjesh të grumbulluara, si p.sh., mbetje inerte) dhe të ketë informacion të saktë mbi numrin e popullsisë/familjeve që marrin shërbim. Format i sugjeruar që bashkitë duhet të plotësojnë për të vlerësuar normën e gjenerimit të mbetjeve shtëpiake nga të dhënat e impianteve tregohet si në tabelën më poshtë:



Tabela III. Norma e gjenerimit e llogaritur nga të dhënat e impianteve të trajtimit

NJA/ Bashkia	Mbetjet shtëpiake të transportuar a në impiant (kg/ditë)	Nr. i popullsis ë CENSU S 2011	Nr. i popullsis ë RGJC	Nr. i popullsis ë MFE	Norma e gjenerimit I (kg/banorë/di të)	Norma e gjenerimit II (kg/banorë/dit ë)	Norma e gjenerimit III (kg/banorë/dit ë)
	A	B	C	D	A/B	A/C	A/D
NJA 1							
NJA 2							
.							
.							
.							
Bashkia Total							

2.2.4 Llogaritja e normës së gjenerimit duke përdorur vëzhgimet/studimet në terren – norma e gjenerimit IV

Për të llogaritur normën e gjenerimit përmes vëzhgimeve në terren bashkia duhet të ndërmarrë të tilla studime të paktën **1 herë në 4 vjet gjatë muajve janar, prill, korrik dhe tetor**, sipas metodologjisë së mëposhtme:

- **Hapi 1.** Ndarja e bashkisë sipas 3 shtresëzimeve për tipologjinë e familjeve – rekomandohet që bashkia të zhvillojë harta, sipas këtyre tri tipologjive

a) *Shtresëzimi 1 – tipologjia urbane*

i. zonat urbane (nr. i familjeve);

ii. zona rurale (nr. i familjeve).

b) *Shtresëzimi 2 – tipologjia e banesave*

i. zona rezidenciale me pallate (nr. i familjeve);

ii. zona rezidenciale me vila në qytet (nr. i familjeve);

iii. zona rezidenciale të përziera me biznese (nr. i familjeve).

iv. zona me shtëpi të ulëta në fshatra

c) *Shtresëzimi 3 – numri i banorëve në familje*

i. familje me > 5 banorë (nr.);

ii. familje me 4 banorë (nr.);

iii. familje me < 3 banorë (nr.).

- **Hapi 2.** Përcaktimi i familjeve kampion dhe stafit që do të angazhohet për zhvillimin e ushtrimit

a) Për secilën nga zonat e përcaktuara më lart duhet të përzgjidhet një numër familjesh, statistikisht të pranueshme për të nxjerrë rezultate, nga numri total i familjeve në atë zonë shtresëzimi (rekomandohet 5% e numrit total të familjeve në atë zonë shtresëzimi).

b) Bashkia, në bashkëpunim me administratorët e pallateve të përzgjedhur, sipas numrit të familjeve, duhet të mundësojë komunikimin paraprak me banorët, në lidhje me ditët kur punonjës të bashkisë do të vijnë dhe të peshojnë mbetjet e gjeneruara prej tyre gjatë 2 javëve të muajve të përzgjedhur (çdo ditë të javës – 1 javë po një javë jo, siç tregohet në tabelën me poshtë) – muaji janar (java 1 dhe 3), muaji prill (java 2 dhe 4), muaji korrik (java 1 dhe 3), muaji tetor (java 2 dhe 4).

- **Hapi 3.** Hartimi i formularëve për marrjen e të dhënave në familjet e përzgjedhura

Tabela IV					
Muaji:	Janar/ prill/ korrik/tetor (<i>zgjidh muajin, kur bëhet anketa</i>)				
Shtresëzimi:	Tipologji urbane/tipologji banese/nr. banorësh për familje (<i>zgjidh tipologjinë, ku bëhet anketa</i>)				
Nr. total i familjeve për shtresëzim:					
Nr. i kampionit të zgjedhur për shtresëzim:					
Java	1	2	3	4	Vendos numrin e javës, kur bëhet anketa:
SASIA E MBETJEVE PËR JAVËN PÛRKATËSE					



	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premtë	E shtunë	E diel	Totali
	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë	kg/ditë
Familja 1								
Familja 2								
.								
.								
Muaji:	Janar prill/ korrik/tetor (zgjidh muajin, kur bëhet anketa)							
Shtresëzimi	Nr. total i familjeve	Nr. i familjeve kampion	Sasia e mbetjeve të peshuara (kg)	Sasia e mbetjeve totale, sipas përzgjedhjes statistikore (kg)	Përcaktimi i normës së gjenerimit në varësi të numri të popullsisë dhe sasisë së mbetjeve që gjenerohen (kg/banorë/ditë)			
Shtesëzimi I: tipologji urbane								
Shtesëzimi II: tipologji banese								
Shtesëzimi III: nr. banorësh për familje								
Total								

- **Hapi 4.** Zhvillimi i fushatës nga punonjësit e bashkisë në bashkëpunim me administratorët e pallateve për peshimin e sasisë së mbetjeve ditore të gjeneruara nga familjet, sipas kalendarit përkatës

- **Hapi 5.** Mbledhja e të dhënave mujore për secilën shtresë dhe mesatarizimi i vlerave mujore

- **Hapi 6.** Përsëritja e ushtrimit gjatë tre muajve të tjerë të vitit

2.3 Sasia e mbetjeve të prodhuara në bashki (ton/vit)

Sasia e mbetjeve të prodhuara në një bashki llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$\text{Sasia e gjeneruar} \left[\frac{\text{ton}}{\text{vit}} \right]$$

$$= \frac{[Nr. i popullsisë (banorë) \times \text{Normën e gjenerimit} \left(\frac{\text{kg}}{\text{banorë/ditë}} \right) * 1000]}{365}$$

Bazuar në të dhënat e llogaritura në pikën 5.2 të normës së gjenerimit, bashkia përdor normën e llogaritur sipas metodologjisë përkatëse dhe bën llogaritjen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara. Në tabelën më poshtë jepet formati që bashkitë duhet të përdorin për të llogaritur sasinë e mbetjeve të gjeneruara:

Tabela V. Sasia e mbetjeve të gjeneruara								
NJA/ Bashkia	Popullsia – Census 2011	Popullsia RGJC	Popullsia MFE	Norma e gjenerimit I	Norma e gjenerimit II	Norma e gjenerimit III	Norma e gjenerimit IV	Sasia e gjeneruar
	A (nr.)	B (nr.)	C (nr.)	D (kg/banorë/ditë)	E (kg/banorë/ditë)	F (kg/banorë/ditë)	G (kg/banorë/ditë)	Ton/vit
NJA 1								Formula më lart, duke përzgjedhur burimet e dy të dhënave të përdorura
NJA 2								
NJA 3								
.								
.								
Total								



2.4 Besueshmëria e të dhënave

Në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme është shumë e rëndësishme që bashkitë të specifikojnë se cilën nga metodat e mësipërme kanë përdorur për të llogaritur: a) numrin e popullsisë; dhe b) normën e gjenerimit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të klasifikuara sipas besueshmërisë metodat e mësipërme:

Shkalla e besueshmërisë	Sasia e mbetjeve të gjeneruara në NJQV
Metoda C (më pak e besueshme)	Gjenerimi i mbetjeve llogaritet si produkt i numrit të popullsisë së regjistruar në gjendjen civile të NJQV-ve me normën e gjenerimit [kg/banorë/ditë] të llogaritur me koeficientët e huazuar nga masterplani apo dokumente të tjera strategjike/ose sipas peshës së kamionëve
Metoda B (mesatarisht e besueshme)	Gjenerimi i mbetjeve llogaritet si produkt i numrit të popullsisë së regjistruar nga INSTAT-i me normën e gjenerimit [kg/banorë/ditë] të llogaritur me regjistrimet e peshë së sasisë së mbetjeve të depozituara në impiantet e trajtimit (të peshuara).
Metoda A (shumë e besueshme)	Gjenerimi i mbetjeve llogaritet si produkt i numrit të popullsisë, sipas formulës së MF-së me normën e gjenerimit [kg/banorë/ditë] të llogaritur nga vëzhgimet/studimet në terren.

III. TË DHËNAT PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE

Në grupin e të dhënave për trajtimin e mbetjeve bëjnë pjesë:

1. Sasia e mbetjeve inerte kg ose ton/vit.
2. Sasia e mbetjeve spitalore kg ose ton/vit.
3. Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill ton/vit.
4. Sasia e mbetjeve të depozituara në incenerator ton/vit.

3.1 Sasia e mbetjeve inerte

Këtu bëhet fjalë për mbetjet e përziera nga ndërtimi dhe shkatërrimi (kodi 17 09 04). Bashkitë duhet të caktojnë pika fundore për grumbullimin e këtij fraksioni të mbetjeve, sipas detyrimit ligjor që kanë të përcaktuar në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, i amenduar, në VKM-në nr. 452, datë 11.7.2012, “Për lëndfillt e mbetjeve dhe VKM-në nr. 575, datë 24.6.2015, ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’”. Zotëruesi i këtyre mbetjeve, i cili është përgjegjës për të gjithë ciklin nga grumbullimi deri në transportin në pikën fundore për trajtim, duhet t’i dërgojë ato në pikën fundore të përcaktuar nga njësi e **vetëqeverisjes** vendore, ku operatori i së cilës është pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, sipas ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i amenduar.

Për mbledhjen e këtij informacioni, bashkia mund të përzgjedhë dy nga metodat e mundshme, sipas shkallës të saktësisë të tyre të shpjeguar më lart:

Metoda A: me peshore të instaluar në impiante ose pika grumbullimi². Këto të dhëna të cilat mbahen nga operatori i pikës për grumbullimin e mbetjeve inerte duhet të raportohen në bashki, sipas detyrimit ligjor në VKM-në nr. 575/2015, “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, deri më 31 janar të çdo viti.

Metoda B: bashkia mund të zgjedhë, që duke evidentuar të gjitha subjektet e ndërtimit që operojnë në territorin e saj, t’i kërkojë raportime vjetore në lidhje me sasinë e mbetjeve inerte që ato gjenerojnë gjatë aktivitetit ndërtimor apo prishjes që ata mund të zhvillojnë. Këto të dhëna bashkia mund t’i kërkojë në disa mënyra që të mundësohen nga operatorët privatë:

a) nga peshimet e rregullta të sasive të mbetjeve inerte që ato dërgojnë apo shkarkojnë për përpunim apo trajtim final;

b) nga llogaritja e peshës me numrin e kamionëve të mbushur dhe kapacitetit të tyre.

Në kuadër të detyrimit ligjor që të gjithë prodhuesit dhe përpunuesit e mbetjeve inerte duhet të raportojnë në bashki çdo vit, bashkia mund të zgjedhë të dërgojë kërkesë zyrtare sipas modelit të shprehur

² Në impiantin e Sharrës është peshorja e instaluar dhe pika për grumbullimin e mbetjeve inerte.



në pikën 6.2. Në aneksin II, të këtij dokumenti, parashikohen formularët që bashkia mund të përdorë për t'ia bashkëngjitur shkresës për kërkesë informacioni të gjeneruesit apo përpunuesit e mbetjeve inerte.

3.2 Sasia e mbetjeve spitalore (duhet zhvilluar)

Bazuar në kodin e katalogut të mbetjeve të përcaktuar në VKM-në nr. 687/2015, “Për statistikën e mbetjeve”, bashkive iu kërkohej sasia e mbetjeve amalgame nga kujdesi dentar, të cilat klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Bazuar në detyrimin ligjor për pajisjen me leje mjedisi, dhe trajtimin e mbetjeve nga palë të treta të licencuara, të gjitha klinikat dentare duhet të plotësojnë rregullisht formularët e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme, sipas VKM-së nr. 371, datë 11.6.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, i cili duhet të jetë në tri kopje (për dorëzuesin e mbetjeve, transportuesin dhe marrësin fundor). Nisur nga ky fakt dhe detyrimin ligjor që bashkitë duhet të raportojnë për këto sasi mbetjesh, më poshtë jepen metodat e mundshme që bashkitë duhet të përdorin për mbledhjen e këtij informacioni:

Metoda A (raportimet nga të gjitha klinikat dentare të regjistruara në bashki/ose nga firmat që grumbullojnë këto fraksione mbetjesh në territorin e bashkisë): Për të mundur këtë proces, bashkitë duhet të dërgojnë në të gjitha klinikat dentare të regjistruar në territorin e tyre apo në ato biznese që kryejnë transportin dhe trajtimin e kësaj kategorie të mbetjeve, kërkesë për mundësim informacioni në muajin shtator (më pas në muajin dhjetor mund të bëjë një rikujtesë për ato biznese që nuk kanë reaguar ende), ku brenda datës 31 janar ky informacion t'i mundësohet bashkisë. Një model që mund të përdoret nga bashkitë tregohet si më poshtë:

Nga Bashkia: XXXX

Drejtuar: Biznesit XXXX

Kërkesë për mundësim informacioni

Bashkia XXX, në kuadër të detyrimit ligjor për mbledhjen dhe raportimin e statistikave të mbetjeve, VKM-së nr. 687, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, kërkon nga biznesi juaj që brenda datës 31 janar të mundësoni evidencat për sasinë e mbetjeve spitalore (18 01 10) – mbetje amalgame nga kujdesi dentar që iu keni gjeneruar dhe dërguar për trajtim gjatë vitit XXX. Ky informacion duhet të mundësohet nga biznesi juaj me nr. NIPT xxxxxxxxxx, pranë zyrave tona me shkresë zyrtare, brenda datës **31 janar të vitit të ardhshëm**, duke ndjekur modelin bashkëngjitur kësaj shkrese!

Biznesi XXX NIPT:	Jana r	Shkur t	Mar s	Pril l	Ma j	Qersho r	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nënto r	Dhjet o	Tota l
Sasia e mbetjeve të amalgame s të kujdesit dentar (kg/muaj)													

Metoda B (vëzhgim në terren mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruar në një ose disa klinika dentare për një javë ose 2 në vit. Kjo metodë mund të përdoret nga bashkitë, duke marrë disa klinika dentare, si kampione për realizimin e ushtrimit, por kjo procedurë do të kërkojë një trajnim të veçantë të stafit të bashkisë për marrjen, kryerjen e matjeve dhe kthimin e mbetjeve të rrezikshme nga amalgama në ambientet e klinikave, gjë të cilën bashkitë nuk kanë kapacitete dhe kompetencë për ta bërë. Na këtë kuadër, ky është një skenar i cili do të funksiononte në ato raste kur klinikat dentare nuk kishin leje mjedisi dhe kontrata për trajtimin e tyre. Në kushtet kur të gjitha klinikat dentare janë në fokusin e pajisjes me leje mjedisi, ku si detyrim kanë kontraktimin e palëve të treta për transportin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme që ato gjenerojnë, metoda e A është ajo që duhet të kuptohet dhe realizohet nga Bashkia.

3.3 Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill

Për të përcaktuar peshën e mbetjeve të grumbulluara në një bashki ekzistojnë këto mënyra:



a) Bashkitë, të cilat i dërgojnë **mbetjet në impiante trajtimi si lëndfill dhe incenerator**, të cilat janë të pajisura me peshore, i peshojnë mbetjet rregullisht përpara se të depozitohen për trajtim final. Këto bashki kanë mundësi të sigurojnë të dhëna të sakta, në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe transportuara për trajtim final në territorin e tyre. Aktualisht bashkitë, të cilat i dërgojnë mbetjet në këto impiante kanë të përcaktuar një supervizor në terren. Sipas manualit zhvilluar nga dldp, HELVETAS, “Modul trajnimi për shërbimet bazuar në performancë”, roli i supervizorit në impiant, si lëndfill apo inceneratori është thelbësor për të marrë të dhëna të sakta për mbetjet që grumbullohen dhe transportohen. Ata kanë përgjegjësinë të kontrollojnë dhe të raportojnë për aktivitetet që ndodhin në impiant, si:

1. Kontrolli dhe grumbullimi i informacionit për shërbimin:

a) raportimi për çdo mjet që hyn në impiant: ID, targa, koha, pronari, lloji i mbetjeve (nëse nuk janë mbetje urbane);

b) raportimi për kohën e saktë të mjetit në fushë;

c) raportimi i çdo incidenti në fushë, si zjarri etj.

2. Kontrolli i cilësisë së mbetjeve:

a) informon bashkinë nëse hyn ndonjë mjet i paidentifikuar në impiant, përveç atyre që janë të planifikuar;

b) lëshon raporte javore për supervizorët e shërbimit.

Ato bashki, të cilat nuk e kanë ende këtë procedurë, duhet të ndjekin procedurat e përcaktuara në kreun VIII, “Procedurat e pranimit të mbetjeve në lëndfill” në VKM-në nr. 452, datë 11.7.2012, “Për lenadfilllet e mbetjeve”, të ndryshuar, pikat 10, 12, 13, 14.

Bashkia: ...		- NJA: ...					
Nr.	Muaji	Data	Targa e mjetit teknologjik	Pesha e mjetit të ngarkuar (kg/ton)	Pesha e mjetit të zbrazur (kg/ton)	Sasia e mbetjeve të depozituara (kg/ton)	Total (kg/ton)
1.							
2.							
3.							
.							
.							

Në sajë të raportimeve të rregullta ditore nga supervizori në impiant për sasinë ditore të mbetjeve që grumbullohet dhe transportohet, bashkitë kanë mundësinë të sigurojnë të dhëna të sakta për t'i hedhur në databazë.

a) Bashkitë, pjesë e zonës së mbetjeve të cilat nuk kanë akoma të ndërtuar dhe funksional një impiant rajonal (lëndfill, incineratorë), i depozitojnë mbetjet në venddepozitime të hapura, dhe nuk janë të pajisura me peshore. Këto bashki përbëjnë shumicën, nga 61, dhe venddepozitimet e tyre: së pari nuk janë të përshtatshme për vendosjen e një peshore për të siguruar peshimin e kamionëve, dhe së dyti venddepozitimet janë nën procesin e rehabilitimit për një kohë të kufizuar deri në 3 vjet, derisa ato të mbyllen plotësisht dhe të tjerët drejt mbylljes. Nisur nga kjo situatë, instalimi i një peshoreje në këto zona nuk do të jetë i realizueshëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sidoqoftë, të dhënat duhet të merren si një kërkesë ligjore, dhe bashkitë duhet të sigurojnë marrjen me qira të peshoreve të përdorura për arsye tregtare dhe të zhvillojnë fushata matëse që mund të organizohen 1 ose 2 javë në vit. Këto fushat duhet të kenë si qëllim:

i. identifikimin e peshoreve që operojnë në zonën e bashkisë – për arsye komerciale;

ii. hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis kompanive që kanë peshoret dhe bashkive për të marrë me qira për 1 ose 2 javë në vit peshoren e tyre për të peshuar kamionët përpara se ato të dërgohen për depozitim final;



iii. zhvillimi i fushatave deri në rishikimin e termave të referencës të kontratave të shërbimit, të cilat do të detyrojnë kompanitë e ofrimit të shërbimit në peshimin e kamionëve të mbetjeve përpara se ato të depozitohen për trajtim final.

Bashkitë duhet të zgjedhin dy javë brenda vitit për të zhvilluar fushatën. Metodologjia propozon të zgjidhet një javë në prill dhe një javë në tetor, pasi muajt e verës dhe dimrit mund të mos japin të dhëna mesatare të sakta. Për një javë, çdo kamion së pari duhet të peshohet bosh, përpara rrugës për grumbullimin e mbetjeve dhe më pas të peshohet kur ngarkohet me mbetje. Ky ushtrim duhet të zhvillohet çdo ditë të javës. Të dhënat mesatare të mbledhura nga kjo javë mund të përdoren si të dhëna referenciale për mbetjet e grumbulluara dhe transportuara. Është e rëndësishme që marrëveshja midis bashkive dhe bizneseve të përcaktojë edhe emërimin e supervisorit nga bashkia që do të regjistrojë të dhënat, siç tregohet në tabelën më poshtë, gjatë të gjithë periudhës të zhvillimit të ushtrimit (dy javë në vit).

BASHKIA: ...		- NJA: ...					
Nr.	Java 1 – muaji prill	Data	Targa e mjetit teknologjik	Pesha e mjetit bosh (kg/ton)	Pesha e mjetit të ngarkuar (kg/ton)	Sasia e mbetjeve (kg/ton)	TOTALI
1	E hënë		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
2	E martë		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
3	E mërkurë		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
4	E enjte		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
5	E premte		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
6	E shtunë		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				
7	E diel		Mjeti 1				
			Mjeti 2				
			.				

3.4 Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator

Kjo sasi matet njësoj si pika 3.3, “Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill”.

3.5 Besueshmëria e të dhënave

Shkalla e besueshmërisë	Sasia e mbetjeve spitalore	Sasia e mbetjeve inerte	Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator/lëndfill
Metoda B (mesatarisht besueshme)	Nuk ka	Sigurojnë të dhëna nga matjet sporadike me peshore të huazuar për një periudhë kohore të kufizuar në një vit, një ose dy javë sipas sezoneve	
Metoda A (shumë e besueshme)	Të dhënat e formate të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme për transport dhe trajtim final	Me peshore të instaluar në impiante	



IV. TË DHËNAT PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR DHE RRYMAT SPECIFIKE TË MBETJEVE

Për sa u takon rrymave specifike të mbetjeve, aktualisht në bashkitë e vendit nuk bëhet grumbullimi i diferencuar i tyre. Në VKM-në nr. 418, datë 25.6.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të marrin masa për të kryer grumbullimin e diferencuar të katër rrymave të mbetjeve: a) letër/karton; b) metal; c) plastikë; ç) qelq dhe të raportojnë rregullisht në AKM për këto rryma çdo 31 janar. Zbatimi i këtyre masave ka pasur tri afate kohore për t'u vënë plotësisht në zbatim nga ana e bashkive: a) fundi i vitit 2016; b) fundi i vitit 2018; c) fundi i vitit 2020, që duhet të shënonte finalizimin e ngritjes së sistemit të grumbullimit të diferencuar, sipas 4 rrymave nëpër bashki, ku të paktën 50% e mbetjeve të riciklueshme të largoheshin nga rryma kryesore e mbetjeve. Në fund të 2020-ës të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kishin të ngritur një sistem grumbullimi mbetjesh sipas tri kategorive: a) Mbetje të riciklueshme të thata; b) Mbetje të riciklueshme të njoma; c) Mbetje të pariciklueshme. Fakt është që kjo shtojcë për VKM-në nr. 687/2015 po hartohet në kushtet kur asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore nuk i ka përmbushur detyrimet e VKM-së nr. 418/2014 dhe nga ana tjetër në formularin e prezantuar në VKM-në për statistikën e mbetjeve kërkohet që bashkitë të plotësojnë me vlera për këto sasi mbetjesh, të cilat realisht nuk i kanë. Në këto kushte, mënyrat që bashkia mund të aplikojë për gjenerimin e këtyre të dhënave ndahen në tri kategori, të cilat nuk mund të vlerësohen me shkallën e saktësisë, por janë alternativa që bashkia mund të zgjedhë dhe t'i zbatojë në varësi të kushteve dhe potencialit financiar dhe njerëzor që ka në dispozicion, bazuar edhe në kuadrin ligjor në fuqi.

A. Të gjitha bizneset që operojnë në territorin e bashkisë dhe merren me prodhimin, përpunimin, grumbullimin apo trajtimin e rrymave specifike të mbetjeve duhet të raportojnë çdo vit në bashki, sipas detyrimit ligjor të legjislacionit në fuqi për këto rryma. Bashkia mund të zgjedhë të dërgojë kërkesa specifike të të gjitha bizneseve për mundësim informacioni.

B. Bashkia vendos të ngrejë qendra grumbullimi të mbetjeve specifike, të cilat operohen nga operatorë privatë. Sipas legjislacionit për rrymat specifike të mbetjeve, këto biznese duhet të raportojnë një herë në vit në bashki, për sasinë e mbetjeve që grumbullojnë apo trajtojnë. Bashkia zgjedh të bëjë kërkesa gjatë vitit për këta operatorë për raportim të dhënash.

C. Bashkia vendos të ngrejë qendra grumbullimi të mbetjeve specifike, të cilat operohen nga vetë ajo. Në këto kushte bashkia duhet të ngrejë një sistem për monitorimin dhe mbajtjen e të dhënave për mbetjet që hyjnë në qendër (pra, për ato që ajo grumbullon) dhe që dalin për trajtim final sipas kategorive specifike. Në këto qendra, Bashkia apo operatori privat mund të zgjedhë të bëjë rikuperim të produkteve apo të materialeve nga përpunimi i produkteve/mbetjeve që hyjnë në qendër.

Në grupin e të dhënave për grumbullimin e diferencuar bëjnë pjesë:

1. Sasia e mbetjeve plastike kg ose ton/vit 17 02 03/15 01 02 – mbetje plastike dhe mbetje ambalazhi plastike;

2. Sasia e mbetjeve të qelqit kg ose ton/vit 15 01 07 – mbetje ambalazhi nga qelqi;

3. Sasia e mbetjeve metalike kg ose ton /vit 17 04 07/ 15 01 04 – metale të përziera dhe mbetje ambalazhi metalike;

4. Sasia e mbetjeve të drurit ton/m³ 17 02 01/15 01 03 – dru dhe mbetje ambalazhi druri;

5. Sasia e mbetjeve të letrës dhe kartonit kg ose ton/vit 15 01 01/03 03 08 – mbetje ambalazhi letre dhe kartoni dhe mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonit për riciklim;

6. Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit 16 06/16 06 01*/16 06 06* – bateri plumbi dhe elektrolite të ndara të mbledhura nga bateri dhe akumulatorë;

7. Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit kg ose ton /vit 16 01 03 – goma jashtë përdorimit;

8. Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorura kg ose ton/vit 12 01 06*/12 01 10* – Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucionëve) dhe vajrat sintetik të makinerive;

9. Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg ose ton/vit 02 01 02 – mbetjet nga indet e kafshëve;



10. Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg ose ton/vit 04/15 01 09 – mbetjet që dalin nga industria e lëkurëve, peliceritë dhe tekstili dhe mbetje ambalazhi tekstil;

11. Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike kg ose ton/vit 16 02/20 01 36 – mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike (*mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur, pajisje skarvo që përmbajnë klorofluorokarbone*).

Bashkia mund të sigurojë këtë informacion përmes rrugëve të mëposhtme:

a) Raportimit të çdo kompanie, e cila ushtron aktivitet në territorin e bashkisë për grumbullimin e fraksioneve të veçanta të mbetjeve. Bashkitë të duhet të kenë informacion për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e tyre, të cilat grumbullojnë apo trajtojnë mbetje të kategorive të ndryshme, si për shembull, fraksione të rrymës të mbetjeve bashkiake, si: organike, plastika, letra dhe karton, qelqi, metalet, druri, tekstili.

Të gjitha njësitë e **vetëqeverisjes** vendore kanë një regjistër të bizneseve private që operojnë në territorin e tyre, pasi atyre u kërkohet të paguajnë taksat dhe tarifat çdo vit. Ndërkohë, të gjitha bizneset që operojnë në territorin e bashkisë bazuar në VKM-të për prodhimin e rrymave specifike duhet të raportojnë çdo vit në njësitë e **vetëqeverisjes** vendore, sasinë e mbetjeve që ato prodhojnë dhe menaxhojnë.

Bashkia duhet të kërkojë raportime të rregullta nga këto kompani, në sajë të një formati të caktuar, i cili duhet të specifikojë, burimin e fraksionit të mbetjes, sasinë që grumbullohet dhe trajtohet dhe sasinë e mbetjeve fundore, të cilat dalin pas procesit të trajtimit. Është shumë e rëndësishme të specifikohet nga kompanitë burimi i lëndës së parë që ato do të hedhin në proces, apo vetëm do të grumbullojnë, për të kuptuar realisht përqindjen e mbetjeve bashkiake që trajtohen veçantë dhe, në përgjithësi, sasinë e fraksioneve specifike, si: plastika, qelqi, letër dhe karton, metale që riciklohen. Ndërkohë, sipas VKM-së nr. 177, datë 6.3.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” në **aneksin II** të kësaj metodologjie mundësohen dy formate, të cilat bashkia mund t’ia bashkëngjisë kërkesës vjetore, që ajo u drejtohet bizneseve që merren me prodhimin, përpunimin, trajtimin, importin apo eksportin e mbetjeve nga ambalazhet: i. formulari për të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg; ii. formulari për të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim.

Bashkitë duhet të sigurojnë që të marrin raportime të rregullta mujore nga këto kompani dhe të filtrojnë informacionin e marrë për ta hedhur në databazë. Bashkitë duhet të kenë kontakte të rregullta me këto kompani dhe të ndajnë me to modelin e raportimit të një formati tip, si më poshtë:

Bashkia: ...	- Kompania: ...	Periudha (muaji): ...
A.A. Sasia e totale e mbetjeve të grumbulluara në këtë periudhë/që hyjnë në impiant [kg/periudhë]: ...		
Burimi i lëndës së parë që hyn në impiant (mund të jetë nga mbetjet kontejnerët, të ndara ose jo, ose lëndë e parë, që nuk grumbullohet kontejnerët)³		
Produkti	Destinacioni	Sasia e prodhuar
	[-]	[kg/periudhë]
Dengu i letrave të kompresuara		
Dengu i plastikës të kompresuar		
..		
B.B.Totali [kg/periudhë]		
C.C.Mbetjet fundore pas procesimit = A - B [kg/periudhë]		

Për të pasur të dhëna sa më të sakta do të mundësohet edhe burimi i të dhënave për këto fraksione specifike të rrymës së mbetjeve bashkiake si në tabelën më poshtë:

³ Këto janë raste kur këto kompani mbledhin, për shembull, plastikë të pastër nga kompani të tjera që nuk e përdorin atë për qëllimet e tyre dhe e përpunojnë atë. Pra, kjo kategori nuk është mbetjet, por do të llogaritet në fund për raportimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të sasisë së plastikës së ricikluar, por nuk duhet të konsiderohet si mbetje plastike e mbledhur dhe e ricikluar.



Bashkia: ...	Periudha (viti): ...			
	A. Materiale jo të rikuperuara *		B. Materiale të rikuperuara	Potenciali (materiale totale të mundshme)
Kategoritë e mbetjeve	Metoda A Llogaritja: Sasia totale e mbetjeve bashkiake* përqindja sipas Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve 2011	Metoda B Matjet: Sasia totale e mbetjeve bashkiake, sipas ushtrimit në terren me matjet që do të kryejë bashkia	Sasia e rikuperuar nga kompani të ndryshme	A + B
	kg/periudhë	kg/periudhë	kg/periudhë	kg/periudhë
Plastikë				
Letër dhe karton				
...				

b) Raportim të rregullt ditor nga çdo impant për riciklimin/kompostimin e mbetjeve – sipas akteve nënligjore për rrymat specifike, të gjitha bizneset, të cilat prodhojnë, përpunojnë, importojnë, eksportojnë dhe trajtojnë rryma specifike të mbetjeve duhet të raportojnë rregullisht çdo fund janari për vitin paraardhës të njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato operojnë. Bashkitë, nisur nga kuadri ligjor në fuqi, për të informuar biznesin dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë dhe reciproke raportimi, mund të dërgojnë njoftime vjetore përpara afatit të dorëzimit të raportimeve të bizneset përkatëse në territorin e saj. Pjesë e ndërtimit të kësaj marrëdhënie të ndërsjellë të bashkisë me bizneset janë edhe takimet vjetore që mund të organizohen si iniciativë e bashkisë me bizneset për të sqaruar procedurën e raportimit dhe rëndësinë e tyre.

c) Vlerësimeve në terren përmes intervistave me sektorin informal/kompanitë e riciklimit që operojnë në territorin e bashkisë. Fakt është që në të gjitha bashkitë ekziston sektori informal, i cili grumbullon rregullisht nga pikat e grumbullimit të mbetjeve apo venddepozitimeve të hapura, kryesisht mbetje të riciklueshme, të cilat hyjnë në linjën e përpunimit, pasi i blen sektori i bizneseve të riciklimit. Në këto kushte bashkitë mund të ngrenë ekipe për evidentimin e tyre dhe zhvillimin e intervistave për të kuptuar sasinë e mbetjeve të riciklueshme që ata grumbullojnë dhe që shkon për industrinë e riciklimit. Bashkia mund të zgjedhë që të kryejë intervista apo anketa 1-2 herë në vit me këtë sektor.

Ndërkohë, përveç formularëve të përmendur më lart si formate raportimi apo mbajtje të dhënash nga ana e bashkive apo edhe bizneseve, në aneksin II janë paraqitur formularët tip që bashkia mund të përdorë për të kërkuar me shkresë zyrtare, të dhëna nga kompanitë që merren me grumbullimin dhe procesimin e rrymave specifike të mbetjeve, 1–2 herë në vit për të kapur afatet e raportimit në institucionet qendrore. Bashkia mund të zgjedhë që të përdorë format e përmendura më lart ose ato në aneks për të kërkuar informacionin për sasinë e rrymave specifike të mbetjeve bizneseve që merren me to.

4.1 Besueshmëria e të dhënave

Në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme është shumë e rëndësishme që bashkitë të specifikojnë se cilën nga metodat e mësipërme kanë përdorur për të llogaritur sasinë e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar:

Shkalla e saktësisë	Grumbullimi në mënyrë të diferencuar
A (më e saktë)	Raportim i çdo kompanie që ushtron aktivitet në territorin e bashkisë për grumbullimin/trajtimin e fraksioneve të veçanta të mbetjeve
B (mesatarisht e saktë)	Raportim nga impantet e riciklimit/kompostimit brenda territorit të bashkisë ose në rajon
C (më pak e saktë)	Vlerësime në terren përmes intervistave



V. TË DHËNAT FINANCIARE PËR LLOGARITJEN E INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS

5.1 Kostoja e plotë e menaxhimit të mbetjeve lek/banorë/vit lek/ton

Të gjitha bashkitë e vendit duhet të fillojnë zbatimin e VKM-së nr. 319, datë 31.5.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, bazuar në udhëzuesin “Metodat e llogaritjes së kostos dhe tarifës në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel njësie të qeverisjes e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri”, të hartuar nga dldp, HELVETAS, për llogaritjen e plotë të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, ku merren në konsideratë të gjitha shërbimet e mbetjeve. Për këtë arsye, bashkitë duhet të jenë shumë të qartë dhe të kenë të dhëna reale, për:

- zonën e shërbimit dhe llojin e saj (urbane, suburbane apo rurale);
- numrin e popullsisë që ata japin shërbimin;
- numrin e turistëve sezonalë;
- normën e gjenerimit të mbetjeve;
- llojin e mjeteve teknologjike/kontejnerëve në terren;
- gjatësinë e rrugës së plotë për grumbullimin e mbetjeve në zonën e shërbimit;
- distanca për në pikën fundore të trajtimit të mbetjeve;
- potencialisht frekuencën e ofrimit të shërbimit në zonat përkatëse;
- tarifën e depozitimit të mbetjeve në impiant.

Në kërkesat për raportime, bashkive iu kërkohen që të raportojnë në lidhje me koston e shërbimeve dhe mirëmbajtjes, planifikimin e të ardhurave dhe realizimin e tyre nga tarifa e pastrimit. Ndonëse pjesa më e madhe e bashkive mund t'i kenë këto të dhëna, ato janë të gjeneruara në mënyra të ndryshme. Në lidhje me këto tri vlera, më poshtë jepen mënyrat e nga më e sakta deri tek më pak e sakta për gjenerimin e këtyre të dhënave:

I. Kostoja e shërbimeve dhe e mirëmbajtjes

Llogaritja e kostos sipas modelit të miratuar me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” dhe miratimi i saj në buxhetin vjetor të bashkisë nga këshilli bashkiak. Kjo është mënyra më e saktë dhe e vetme që njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të përdorin për llogaritjen e kostos të shërbimeve të mbetjeve dhe ta bëjnë pjesë të buxhetit vjetor që miratohet çdo vit në këshillat bashkiakë përkatës. Ky dokument final i miratuar disponohet nga Zyra e Financës dhe Buxhetit në çdo bashki.

Shkalla e besueshmërisë	Kostoja e shërbimeve dhe mirëmbajtjes
A (më e saktë)	Kostoja sipas modelit të VKM-së dhe miratuar në Këshill Bashkiak

5.2 Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit

Të ardhurat e planifikuara të llogaritura nga niveli i tarifave, të llogaritura sipas VKM-së për çdo kategori të konsumatorëve, dhe miratuar në paketën fiskale me vendim të këshillit bashkiak, me numrin e klientëve sipas kategorive në databazën e instaluar në zyrën e taksave dhe tarifave vendore në bashki. Kjo është mënyra më e saktë dhe e vetme për planifikimin e të ardhurave, ku bashkia llogarit tarifën bazuar në koston e shërbimit, sipas modelit të miratuar me VKM-në për çdo kategori të konsumatorëve, dhe planifikon të ardhurat bazuar në numrin e klientëve të detajuar, sipas kategorive, të miratuara në paketën fiskale me vendim të këshillit bashkiak.

Shkalla e besueshmërisë	Planifikimi i të ardhurave nga tarfa e pastrimit
A (më e saktë)	Planifikimi i të ardhurave sipas tarifave të llogaritura për çdo kategori konsumatorësh, sipas modelit të VKM-së, miratuar në paketë fiskale dhe me numrin e detajuar të konsumatorëve në databazën e Zyrës të Taksave dhe Tarifave Vendore



5.3 Realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit

a) Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit mblidhen nga zyrat e taksave dhe tarifave vendore bazuar nga arkëtimet e faturave të personalizuar për secilën kategori të konsumatorëve. Kjo është metoda më e saktë, ku zyra e tarifave dhe e taksave vendore hedh në databazën e saj pagesat e personalizuar për secilën kategori të konsumatorëve të detajuar. Këto të ardhura mund të mblidhen nga vetë zyra e taksave dhe tarifave vendore ose nga agjentë të jashtëm, të cilët ia komunikojnë zyrës së bashkisë.

b) Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit mblidhen nga zyra e taksave dhe tarifave vendore si total, pa u detajuar sipas kategorive të konsumatorëve. Kjo është metoda mesatarisht e saktë, ku zyra e taksave dhe tarifave vendore, nuk mban evidenca të detajuara për secilën kategori të konsumatorëve, por thjeshtë arkëton tarifat e pastrimit si total për të gjithë bashkinë (pa kuptuar cila kategori ka kontribuar më shumë dhe sa për qind e tyre kanë paguar).

c) Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit nuk mblidhen të veçanta nga tarifat e tjera, por janë një shumë totale e të gjithë tarifave vendore të paguara nga konsumatorë të ndryshëm. Kjo është metoda më pak e saktë, pasi zyra e taksave dhe tarifa vendore ka një informacion shumë të përgjithshëm me detyrimet vendore që duhet të paguajnë konsumatorë të ndryshëm, por nuk ka të detajuar në databazë shumat përkatëse për secilën kategori të tarifave vendore. Në këtë rast bashkia e ka të pamundur të kuptojë realizimin vjetor të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

Shkalla e besueshmërisë	Realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit
A (më e saktë)	Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit bazuar nga arkëtimet e faturave të personalizuar për secilën kategori të konsumatorëve
B (mesatarisht e saktë)	Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit si total, pa u detajuar sipas kategorive të konsumatorëve
C (më pak e saktë)	Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit si një shumë totale e të gjithë tarifave vendore të paguara nga konsumatorë të ndryshëm

5.4 Sasia e të ardhurave të planifikuara dhe të grumbulluara nga tarifat e menaxhimit të mbetjeve

Ndërkohë, zyra e taksave dhe e tarifave në bashkisë është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me nivelin e tarifave për konsumatorët, planifikimin e tyre dhe realizimit të të ardhurave. Ata duhet të kenë parasysh dhe t'i kushtojnë vëmendje, së bashku me zyrën e financave dhe zyrën e shërbimeve publike, që të hartojnë një politikë fiskale të përshtatshme për kontekstin vendor, duke synuar sigurimin e qëndrueshëm të shërbimit dhe rikuperimin e plotë të kostos.

Të gjitha të dhëna që kërkohen duhet të grumbullohen pranë zyrës së taksave dhe tarifave dhe të përditësohen rregullisht, bazuar në të gjitha ndryshimet e zhvilluara në kohë reale. Kërkohet që të adresohen shifra specifike për të tria llojet e konsumatorëve, për të kuptuar peshën që ato kanë në të ardhurat fiskale, dhe cili konsumator kontribuon më shumë (*ka barrën më të lartë*) në mbulimin e kostos nga tarifat. Kjo do të ndihmojë bashkitë të kuptojnë nëse politikat e tyre fiskale në kohë duhet të ndryshohen kundrejt konsumatorëve.

Gjithashtu është e rëndësishme që të ardhurat të jenë mbledhur në të njëjtin vit financiar, duke shmangur kështu krijimin dhe akumulimin e borxheve. Të ardhurat vjetore nga menaxhimi i mbetjeve përfshijnë vetëm të ardhurat e mbledhura për faturat e dërguara përgjatë vitit në fjalë. Nga këto të ardhura duhet të përjashtohet mbledhja e borxheve nga vitet e mëparshme:

Konsumatorët	Nr.	Tarifa	Parashikimi për vitin 2019	Grumbullimi për vitin 2019
Familjare				
Biznese të vogla				
Biznese të mëdha				
Institucione				
Total				

Në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme është shumë e rëndësishme që bashkitë të specifikojnë së cilën nga metodat e mësipërme kanë përdorur për të llogaritur të ardhurat e parashikuara dhe të grumbulluara

Shkalla e saktësisë	Parashikimi dhe grumbullimi i të ardhurave
A (më e saktë)	Bashkitë lëshojnë faturë që specifikon tarifën e mbetjeve për çdo kategori klienti. Rekorder të mbledhjes së faturave mirëmbahen për çdo cikël të lëshimit të faturave. Mbledhjet e faturave janë të identifikuara kundrejt çdo fature specifike që është lëshuar. Struktura e kodeve të kontabilitetit, gjithashtu, lejon monitorimin e lëshimit të faturave dhe mbledhjes së tyre për çdo zonë/njësi administrative të NJVQV-së.
B (mesatarisht e saktë)	Ekziston një ndarje e qartë e të ardhurave të mbledhura në vitin aktual me mbledhjen e borxheve të akumuluar në vite. Megjithatë të ardhurat e mbledhura nuk përputhen kundrejt faturave specifike të lëshuara në atë vit.
C (më pak e saktë)	Bashkitë nuk lëshojnë fatura për të gjithë klientët ose faturat janë për disa tarifa së bashku. Gjithashtu, nuk ekziston një regjistrë që të ndajë të ardhurat e prapambetura (borxheve) nga të ardhurat e mbledhura përgjatë vitit aktual. Struktura e kodeve të kontabilitetit nuk na mundëson një ndarje të qartë të të ardhurave.

VI. MATJA E PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT

6.1 Indikatori 1. Mbulimi i zonës me shërbim (në %)

Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve urbane të mbledhura në NJVQV, nga autoritetet e autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi, kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara në këtë NJQV. Ky indikator është i thjeshtë për t'u matur dhe është gjerësisht i sugjeruar nga literatura për t'u përdorur në matjen e eficiencës së grumbullimit të mbetjeve. Megjithatë, besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikatori (shiko pikat e mësipërme) si në formulën e mëposhtme:

$$Ind\ 1 = \frac{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ grumbulluara\ (\frac{ton}{vit})}{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ prodhuara\ (\frac{ton}{vit})} \times 100$$

6.2 Indikatori 2. Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve

Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve urbane të mbledhura në mënyrë të diferencuar në NJVQV nga autoritetet e autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Është e rëndësishme që ky indikator të llogaritet mbi bazën e sasinë së mbetjeve të mbledhura në mënyrë të veçantë, të cilat arrijnë të ndara në qendrat e trajtimit (impiantet). Nëse është e mundur dhe ekziston informacioni i sasisë së mbetjeve të mbledhura nga sektori informal në pika të ndryshme të sistemit, atëherë duhet që, sasisë së mbetjeve që mbërrijnë të ndara në qendrat e trajtimit t'u shtohet edhe sasia e grumbulluar në mënyrë të veçantë nga sektori informal. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikatori (shiko pikat e mësipërme), si në formulën e mëposhtme:

$$Ind\ 2 = \frac{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ grumbulluar\ në\ menyre\ të\ diferencuar\ (\frac{ton}{vit})}{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ grumbulluara} \times 100$$

6.3 Indikatori 3. Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin

Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohet në lëndfill, incinerator, impiant kompostimi apo riciklimi, të cilat janë projektuar, ndërtuar si dhe operojnë dhe mirëmbahen, në përputhje me standardet e aprovuara nga institucionet e nivelit qendror. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikatori (shiko pikat e mësipërme) si në formulën e mëposhtme:

$$Ind\ 3 = \frac{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ trajtuara\ ne\ impinte\ (\frac{ton}{vit})}{Sasia\ e\ mbetjeve\ të\ grumbulluara\ (\frac{ton}{vit})} \times 100$$



6.4 Indikatori 4. Eficiencia në mbledhjen e tarifave

Ky indikator shpreh se sa është shkalla e realizimit të planifikimit në mbledhjen e tarifave. Ky indikator është i përcaktuar si përqindje e raportit të të ardhurave të grumbulluara në vitin aktual me totalin e të ardhurave të planifikuara për këtë vit. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikator (shiko pikat e mësipërme), si në formulën e mëposhtme.

$$Ind\ 4 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga menaxhimi i mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Të ardhurat e planifikuara për t'u mbledhur} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

6.5 Indikatori 5. Shkalla e rikuperimit të kostos

Ky indikator shpreh se sa është shkalla e mbulimit të kostos operative të menaxhimit të mbetjeve nga NJVQV, nga të ardhurat që lidhen ekskluzivisht me menaxhimin e mbetjeve. Ky indikator është i përcaktuar si një përqindje e të ardhurave operative në sistemin e menaxhimit të mbetjeve në raport me koston operative të shërbimit. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikator (shiko pikat e mësipërme) si në formulën e mëposhtme.

$$Ind\ 5 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga menaxhimi i mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kostot operative të menaxhimit të mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

6.6 Indikatori 6. Cilësia e shërbimit

Ky është një indikator cilësor i përbërë, i cili është detajuar në 5 nënkomponentë, ku secili prej tyre vlerësohet me pikë sipas kriteret të vlerësimit të përshkruar në tabelën e mëposhtme:

1	Prezenca e kontejnerëve të dëmtuar që nuk janë riparuar (pa rrota, të deformuar pa kapak)	Kontejnerë shumë të dëmtuar, të djegur Kontejnerë me dëmtime strukturore (të deformuar, të çarë) Kontejnerë me dëmtime mesatare (mungesë rrotash) Kontejnerë pak të dëmtuar me (mungesa kapaku) Kontejnerë shumë pak të dëmtuar	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
2	Prezenca e mbetjeve të akumuluar rreth kontejnerit pas kryerjes së shërbimit	Prezencë e madhe e mbetjeve të hapura në tokë rreth kontejnerëve ose anës së tyre Prezencë e qeseve të mbyllura me mbetje rreth kontejnerëve Prezencë e pakët e mbetjeve të pafshira përreth kontejnerëve Prezencë e vogël e mbetjeve dhe mosdezinfektim i kontejnerëve Kontejnerë të pastër të dezinfektuar dhe të larë	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
3	Prezenca e mbetjeve në rrugët kryesore pas kryerjes së fshirjes/larjes	Prezencë shumë e madhe e mbetjeve të hapura në të gjithë sipërfaqen e rrugës Prezencë e madhe e mbetjeve të përhapura anës rrugës pranë trotuareve Prezencë mesatare e mbetjeve anës kunetave të rrugëve Prezencë e vogël e mbetjeve, copa të vogla mbetjesh të riciklueshme Prezencë shumë e vogël e mbetjeve	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
4	Prezenca e mbetjeve në periferi, pika ilegale dhe djegia e mbetjeve në kontejnerë	Prezencë e mbetjeve që digjen anës rrugëve Prezencë e pikave ilegale historike të grumbullimit të mbetjeve Prezencë e mbetjeve të përhapura në rrugë si pasojë e mungesës së grumbullimit Prezencë e vogël e mbetjeve vetëm përreth kontejnerëve Prezencë shumë e vogël e mbetjeve të përhapura në rrugë	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
5	Përdorimi i mjeteve personale mbrojtëse nga punëtorët e pastrimit dhe zbatimi i protokollove në rast incidentesh	Nuk ka asnjë përputhje me përdorimin e mjeteve personale mbrojtëse Ka përputhje të ulët Ka përputhje të mesme Ka përputhje mesatarisht të lartë Ka përputhje të lartë	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë



Ky indikator vlerësohet dy herë, nga vetë inspektorët e shërbimit në bashki dhe nga vlerësues monitorues jashtë bashkisë. Ai llogaritet si mesatarizim i pikëve të grumbulluara për çdo nën komponent.

6.7 Indikator 7. Kënaqësia e publikut

Ky indikator mund të llogaritet në dy mënyra:

a) Matja e eficiencës në adresimin e ankesave të klientëve:

$$Ind\ 7 = \frac{Numri\ i\ ankesave\ të\ adresuara\ përgjatë\ një\ viti}{Numri\ i\ ankesave\ të\ marra\ përgjatë\ një\ viti} \times 100$$

b) Matja e shkallës së kënaqësisë së publikut për shërbimin e pastrimit. Kjo realizohet me anë të një pyetësoi që është bashkëlidhur në aneksin e kësaj metodologjie.

6.8 Indikator 8. Vlerësimi i rolit të bashkisë në cilësinë e shërbimit të ofruar

Ky është një indikator cilësor i përbërë, i cili është detajuar në 5 nënkomponentë, ku secili prej tyre vlerësohet me pikë sipas kriterëve të vlerësimit të përshkruar në tabelën e mëposhtme:

1	Plani lokal për menaxhimin e mbetjeve	Nëse bashkia nuk ka plan për menaxhimin e mbetjeve Nëse bashkia ka një plan të pamiruar nga Këshilli Bashkiak Nëse plani është i miratuar nga Këshilli Bashkiak Nëse plani është në koherencë me politikat kombëtare Nëse plani është i shoqëruar edhe me rregulloren e brendshme të menaxhimit të mbetjeve të miratuar në Këshillin Bashkiak	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
2	Zbatueshmëria e planit	Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është < 30% Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 31–40% Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 41–60% Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 61–80% Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është > 81%	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
3	Struktura organizative	Nëse bashkia ka vetëm një person përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve Nëse bashkia ka një strukturë me të paktën 3 persona (sektor) Nëse bashkia ka një departament me disa sektorë/me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara Nëse të gjitha vendet e strukturës janë të plotësuara me staf të përshtatshëm për atë pozicion Nëse stafi trajnohet të paktën 2 herë në vit për çështjet e menaxhimit të mbetjeve	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
4	Ekzistenca e të dhënave për mbetjet/databazë	Bashkia ka evidenca të matjes ditore mujore të sasisë së grumbulluar të mbetjeve, por jo një databazë, ku regjistron çdo ditë/muaj këto të dhëna Bashkia ka një regjister për të dhënat, por të fragmentarizuar, jo të plotësuar të përditësuar Bashkia kryen matje dhe vlerësime në mënyrë të rregullt të sasisë së gjeneruar të mbetjeve, përbërjes mercologjike, sasisë së grumbulluar, të ricikluar dhe të trajtuar Bashkia plotëson databazën bazuar vetëm në matje, sipas procedurave dhe metodologjive standarde dhe jo në bazë të sugjerimeve/vlerësimeve/përafrimeve Bashkia ka staf të dedikuar për grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave dhe për vlerësimin e performancës së shërbimit	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
5	Sistemi i monitorimit	Bashkia ka supervisor për monitorimin e shërbimit/por ka mungesë evidencash statistikore që përcaktojnë sasinë dhe cilësinë e shërbimit të ofruar Bashkia ka supervisor për monitorimin dhe evidenca përshkrimore për shërbimin, por mungojnë indikatorët e performancës dhe matjes së cilësisë së shërbimit	0 pikë 5 pikë 1



	Bashkia ka procedura standarde të miratuara për monitorimin e shërbimit dhe matjen e indikatorëve të performancës	0 pikë
	Bashkia ka hartuar penalitete për moskryerjen e shërbimit, sipas kontratës të miratuara në këshillin bashkiak	15 pikë
	Bashkia ka supervisor të kualifikuar mjaftueshëm për sistemin e monitorimit dhe me akses në mjetet e transportit	20 pikë

Ky indikator vlerësohet dy herë, nga vetë inspektorët e shërbimit në bashki dhe nga vlerësues monitorues jashtë bashkisë. Ai llogaritet si mesatarizim i pikëve të grumbulluara për çdo nën komponent.

ANEKS I PYETËSORI PËR MATJEN E KËNAQËSISË SË PUBLIKUT

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E KËNAQËSISË QYTETARE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË

Bashkia	Njësia administrative	Data e intervistës	Nr. i pyetësorit
.....			

Ky pyetësor realizohet nga Bashkia dhe ka si qëllim të vlerësojë shkallën e kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e pastrimit të ofruar nga Bashkia përgjigjet tuaja janë konfidenciale, dhe nuk do të publikohen apo nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër përveçse për të vlerësuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

1. A ofrohet shërbimi i grumbullimit, transportit dhe pastrimit të rrugëve në zonën ku Ju banoni?

a Po	b Jo
------	------

1.1 Nëse po, sa të kënaqur jeni Ju me cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku Ju banoni?

a Shumë të kënaqur	b Të kënaqur	c Neutral
d Të pakënaqur	e Shumë të pakënaqur	f Tjetër.....

1.2 Nëse jo cilat prej alternativave të mëposhtme Ju mendojnë që ndikon më shumë në cilësinë aktuale të shërbimit të pastrimit në zonën ku Ju banoni?

a Nr. i kontejnerëve nuk është i mjaftueshëm	b Frekuenca e shërbimit nuk është e mjaftueshme	c Kontejnerët tejmbushen nga bizneset e zonës
d Qytetaret i hedhin mbetjet jashtë kontejnerëve	e Aktiviteti ilegal i grumbulluesve të mbetjeve riciklueshme	f Tjetër.....

2. A është i mjaftueshëm numri i kontejnerëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën ku Ju banoni?

a Po	b Jo	c Tjetër.....
------	------	---------------

**3. Sipas informacionit që Ju keni, sa herë ndodh mbledhja e mbetjeve në zonën ku Ju banoni?**

- a Çdo ditë b 2 herë në ditë c Sa herë _____ në javë
- d Nuk ka rregull e Nuk e di f Tjetër _____

4. Sipas mendimi tuaj si do të vlerësonit, Ju shkallën e pastërtisë së rrugëve dhe shesheve kryesore në bashkinë tuaj?

- a Shumë të pastra b Të pastra c Neutral
- d Të papastra e Shumë të papastra f Tjetër _____

5. Sipas mendimit tuaj cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon më shumë në cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku Ju banoni?

- a Prezenca e mbetjeve të akumuluar përrreth kontejnerëve para se të kryhet shërbimi b Prezenca e mbetjeve të akumuluar përrreth kontejnerëve, pasi kryhet shërbimi c Prezenca e mbeturinave në rrugët kryesore të qytetit dhe në vendet më të populluara
- d Prezenca e mbetjeve të akumuluar në rrugët periferike ose anës së tyre e Djegie e mbeturinave në zonat periferike/rurale f Tjetër _____

6. A Paguani ju një tarifë për shërbimin e pastrimit?

- a Po b Jo c Tjetër _____

6.1 Nëse po, sa është tarifa për shërbimin e pastrimit që Ju paguani? _____ lek/vit

6.2 Nëse jo cila është arsyeja që Ju nuk e paguani tarifën e shërbimit?

7. A do të ishit Ju të gatshëm të paguanit një tarifë më të lartë për një qytet më të pastër? Ju lutemi zgjidhni një prej alternativave të mëposhtme:

- a Po b Jo c Tjetër _____

8. A jeni Ju të informuar për çështje e shërbimit të pastrimit si grumbullimi, transporti dhe ku asgjësohen mbetjet?

- a Po b Jo

8.1 Nëse po, nëpërmjet kujt mjeteve të komunikimit e merrni Ju këtë informacion?

- a Media lokale e Faqet e internetit të bashkisë dhe rrjetet sociale të saj
- b Fatura që më vjen në shtëpi ka informacion ndërgjegjësues f Rrethi shoqëror
- c Fletëpalosjeve të ndryshme g Tjetër (specifiko)
- d Njoftimeve të shpallura nga bashkia në këndin e njoftimeve



9. Sipas mendimit tuaj si mund të ndikojnë qytetarët në përmirësimin e shërbimit të pastrimit? Ju lutemi zgjidhni nga 1 deri në 3 nga alternativat e mëposhtme, duke i renditur sipas rëndësisë duke filluar nga 1 si më e rëndësishmja:

a	Të paguajnë tarifën e pastrimit	d	Pastrim vullnetar
b	Të hedhin mbetjet në vendin e caktuar	e	Nuk e di
c	Të mbajnë pastër hapësirat publike	f	Tjetër

10. Sipas mendimit tuaj, cilat prej masave të mëposhtme Bashkia duhet të ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit të pastrimit? Ju lutemi zgjidhni nga 1 deri në 3 nga alternativat e mëposhtme, duke i renditur sipas rëndësisë duke filluar nga 1 si më e rëndësishmja:

a	Të rrisë frekuencën e ofrimit të shërbimit	d	Të ofrojë infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve
b	Të shtojë numrin e punëtorëve që mirëmbajnë rrugët dhe sheshet kryesore	e	Të rrisë tarifën e pastrimit për të financuar një shërbim më të mirë
c	Të shtojë numrin e kontejnerëve dhe koshave rrugorë	f	Të intensifikojë komunikimin me qytetarët dhe me bizneset përmes fushatave të informimit dhe sensibilizimit
g	Tjetër		

Duke Ju falënderuar për përgjigjet, në përfundim të këtij pyetësi do të dëshironim të kishim një vlerësim final nga Ju për cilësinë e shërbimit të pastrimit për bashkinë Shkodër. Nga 1 deri në 10, cilën notë do t'i jepnit këtij shërbimi?

ANEKS II

FORMULARËT QË MUND TË PËRDOREN NGA BASHKITË PËR TË KËRKUAR RAPORTIME TË RREGULLTA NGA KOMPANITË QË MERREN ME GRUMBULLIMIN DHE TRAJTIMIN E RRYMAVE SPECIFIKE TË MBETJEVE

I. Formulari për të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg

1. Të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg: _____ datë _____				
2. Të dhënat për prodhuesin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____				
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është hedhur në treg				
Lloji i materialit të ambalazhit	Sasia e hedhur në treg (kg/vit)	Sasia e ambalazhit të hedhur në treg- njësia e ambalazhit (copë)	Sasia e ambalazhit të: eksportuar (kg/vit)	Sasia e ambalazhit të: importuar (kg/vit)
Qelq				
Metal				
Letër/karton dhe ambalazh shumë shtresor				
Plastikë				
Dru				
Ambalazh prej materialeve të tjera				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				



II. Formulari për të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe të çuar në përpunim, riciklim

1. Të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim: _____, datë _____

2. Të dhënat për prodhuesin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është hedhur në treg

Lloji i materialit të ambalazhit	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia për riciklim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Qelq				
Metal				
Letër/karton dhe ambalazh shumë shtresor				
Plastikë				
Dru				
Ambalazh prej materialeve të tjera				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

III. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve inerte

A. Për operatorët e pikave të grumbullimit të mbetjeve inerte

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve inerte që transportohen në pikën e grumbullimit të mbetjeve inerte: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve inerte

Kodi i mbetjeve inerte 17 09 04	Sasia e përgjithshme e grumbulluar në pikë (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe prishjet (jo të rrezikshme)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përmbajnë merkur (Hg)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përmbajnë PCB				
Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përmbajnë substanca të rrezikshme				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

**B. Subjektet e ndërtimit në territorin e bashkisë**

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve inerte që gjenerohen në kantierin e ndërtimit: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve inerte

Kodi i mbetjeve inerte 17 09 04	Sasia e përgjithshme e gjeneruar në kantier (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe prishjet (jo të rrezikshme)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përmbajnë merkur (Hg)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përmbajnë PCB				
Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përmbajnë substanca të rrezikshme				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

IV. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike që gjenerohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike

Kodi i mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike 16 02/20 01 36	Sasia e përgjithshme e gjeneruar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike - Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur (mbetje të rrezikshme)				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone (mbetje të rrezikshme)				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____



1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike

Kodi i mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike 16 02/20 01 36	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike - mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur (mbetje të rrezikshme)				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone (mbetje të rrezikshme)				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

V. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët që gjenerohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët

Kodi i mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët 16 06/16 06 01/16 06 06	Sasia e përgjithshme e gjeneruar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Bateri dhe akumulatorë				
Bateri plumbi (të rrezikshme)				
Elektrolite të ndara të mbledhura nga bateri dhe akumulatorë të tjerë (të rrezikshëm)				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët



Kodi i mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët 16 06/16 06 01/16 06 06	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Bateri dhe akumulatorë				
Bateri plumbi (të rrezikshme)				
Elektrolite të ndara të mbledhur nga bateri dhe akumulatorë të tjerë (të rrezikshme)				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

VI. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdorur

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdorur që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdorur:

Kodi i mbetjeve nga vajrat e përdorur 12 01 06 / 12 01 10	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Vajrat minerale të makinerive, që përmbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucionëve) (të rrezikshme)				
Vajrat sintetike të makinerive (të rrezikshme)				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

VII. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit:

Kodi i mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit 16 01 03/ 400 000 00	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Gomat jashtë përdorimit				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

**VIII. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga produkte e kafshëve**

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve që gjenerohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve:

Kodi i mbetjeve nga produktet e kafshëve 02 01 02	Sasia e përgjithshme e gjeneruar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetjet nga indet e kafshëve				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____, datë _____

2. Të dhënat për operatorin: Kompania _____; personi i kontaktit _____; adresa: _____

3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve:

Kodi i mbetjeve nga produktet e kafshëve 02 01 02	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar për ripërdorim (kg/vit)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e eksportuar (kg/vit)
Mbetjet nga indet e kafshëve				
Total				

Personi përgjegjës për të dhënat: _____

VENDIM**Nr. 175, datë 23.8.2021**

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gerrat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, gerrat “a” dhe “e”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij

Faqe | 14270

të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/3 prot., datë 16.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Terfoja’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Terfoja’ dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”.

- Nga aplikimi i shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. vërehet se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për këtë veprimtari, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, dhe është përcjellë kryesisht dokumentacion për nevojat e këtij aplikimi.



- Bazuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, dhe në nenin 9, pika 3, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, duke qenë se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, atëherë dhe dokumentacioni i depozituar nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dhe dokumentacioni i paraqitur nga ai për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 176, datë 23.8.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGIJËS ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” dhe “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a” dhe “e”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/3 prot., datë 16.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Terfoja’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Terfoja’ dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga aplikimi i shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., vërehet se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për këtë veprimtari, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” dhe është përcjellë kryesisht dokumentacioni për nevojën e këtij aplikimi.

- Bazuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, dhe në nenin 9, pika 3, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, duke qenë se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, atëherë dhe dokumentacioni i depozituar nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.



- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit, dhe dokumentacioni i paraqitur nga ai për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 177, datë 23.8.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 55, DATË 22.2.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ARIS ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘GURI I ZI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC ‘DAZNJANË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, DHE HEC ‘SHËLLI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/4 prot., datë 19.8.2021, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Guri i Zi’, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC ‘Daznjanë’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC ‘Shëlli’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 22.2.2021, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi”, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë”, me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli”, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë”, nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi”, dhe nr. 101 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Shëlli”, shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i



paraqesë në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 16.7.2021), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

- Me shkresën nr. 399/1 prot., datë 22.7.2021, ERE ka rikujtuar shoqërinë, në lidhje me detyrimin e plotësimit, brenda afatit, të kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit të sipërcituar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 399/2 prot., datë 13.8.2021, shoqëria ka depozituar kontratat e rinovuara me Bashkinë Mat, përkatësisht për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor në pronësi/administrim të kësaj bashkie, për ndërtimin e HEC “Daznjanë”, “Guri i Zi” dhe “Shëlli”.

- Sa konstatohet nga përmbajtja e këtyre kontratave, rezulton se afati i qirasë përfundon më 15.7.2022, ndaj, pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.1.2021, duhet të ndryshohet, duke i lënë kusht shoqërisë, që në përfundim të këtij afati, t’i depozitojë ato, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 (një) muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, ndryshon si vijon:

“3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 15.7.2022), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë ato në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 (një) muaj nga nënshkrimi i rinovimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 178, datë 23.8.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 401, SERIA T18, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 72, DATË 26.3.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “dh”; të nenit 7, paragrafi 2, dhe të nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/1 prot., datë 16.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SMART WATT’ sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 2.3.2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018, të ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 38 prot., datë 10.8.2021, shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. ka kërkuar me vullnetin e saj heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për arsye se nuk e ushtron këtë aktivitet.

- Kërkesa e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “dh”, të



“Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe të pikës 5.1, germa “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

- Në nenin 7, paragrafi i dytë, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje.”.

- Sa rakordohet me Drejtorinë Ekonomike dhe të Financës në ERE, subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit.

- Me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s, licenca nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018, bëhet e pavlefshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 179, datë 23.8.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN KORRIK 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 113/5 prot., datë 20.8.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 7272 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për muajin korrik 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të



rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kwh.

- **Sasia e energjisë elektrike e prokuruar vetëm në treg të parregulluar është 1,488 mwh.**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e

ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin korrik 2021				
Korrik 2021		Aplikimi FSHU Përlllogaritjet e sh.a. ERE-s		
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	lekë/kwh	10.974	10.974
Pr	Kthimi për riskun, i përcaktuar në përqindje, për vitin (3%)	lekë/kwh	0.19	0.33
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	lekë/kwh	6.44	11.30
CA	Kostoja administrative e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	lekë/kwh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	lekë/kwh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	lekë/kwh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		lekë	1	1

- Për sa përcaktohet, për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, si dhe vlerësimeve të ERE-s, sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021, të jetë 15.34 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, prej 15.34 lekë/kwh, për muajin korrik 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 586 (3233), datë 8.6.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Albana Pjetër Lleshi, e lindur më datë 4.9.1997, në Dom, Bashkia Pukë, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shoqatës bamirëse “Misionarët e Bamirësisë” (Motrat e Nënë Terezës), Shkodër, “Projekti Shpresa”.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2543, datë 14.4.2021, vendosi shpalljen të zhdukur në datën 3.7.2017, të shtetasit Adriano Jaho, i biri i Isufit dhe i Zifes, i datëlindjes 30.3.1965, si dhe caktimin e shtetases Suzana Jahaj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë